



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Pogradec më 21/04/2016

Raport

Mbi ecurinë e punës për Hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për bashkinë Pogradec (faza e parë).

Më datën 21.04.2016, u zhvillua takimi me grupin e punës, ekspertët, Drejtoret e Drejtorive, Specialistë të Bashkisë dhe studios konsulente Konsorciumi BOLLES+WILSONGMB&CD IDRA sh.p.k për dëgjuesën dhe diskutimin e dokumentacionit të analizës ekzistuese për Hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Pogradec, paraqitur nga studio konsulente.

Fjalën e hapjes e mban z.Eduart Kapri, Kryetar i Bashkisë dhe autoriteti përgjegjës për Hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Midis të tjerash duke bere te njohur auditorin per rendesine e procesit të mbështetur në kontratën tripalëshe e lidhur midis ministrisë së Zhvillimit Urban, Bashkisë Pogradec dhe studios BOLLES+WILSONGMB&CD IDRA sh.p.k sqaroi auditorin për territorin administrativ të njesise vendore sot, ecurinë e zhvillimit të ndertimeve në përgjithesi pas viteve 90 .

Ai theksoi jo vetëm për administrimin e territorit dhe njohjen e problematikave te planifikimit të territorit,ndërtimeve ne qytet por dhe të njesive administrative perberese te Bashkisë Pogradec e konkretisht, Njësive Administrative, Buçimas, Udënisht, Çërravë, Dardhas, Proptisht, Trebinjë dhe Velçan.

Duke qënë në breg te liqenit dhe vazhdimësi e zhvillimit urban të qytetit për Buçimasin dhe Udënishtin duhet të evidentohen dhe saktësohen të gjitha problemet në analizën ekzistuese të hartimit të planit.

Mendoj se gjithe stafi i bashkise grupi i punes,ekspertët,drejtoret e drejtorive dhe specialiste të Bashkisë do të punojnë me përkushtim për informimin dhe dhënien e të gjithë dokumentacionit qe disponon bashkia.

Më pas fjalën e mer z.Auron Pashaj përfaqësues i studios BOLLES+WILSONGMB&CD IDRA sh.p.k i cili në emër të grupit të specialistëve shpjegon punën e kryer deri tani "Për hartimin e analizës dhe vlerësimit të territorit për të gjithë bashkinë".

Çdo grup ekspertësh sipas specifikës të analizës do të relatojnë mbi punën e kryer.

Ai theksoi se pamvaresisht nga puna e kryer mirëpresin çdo vërejtje dhe sugjerim për dokumentin e paraqitur .

z.Myslim Pashaj shpjegoi analizën e kryer për topografinë dhe relievin e territorit të gjithë bashkisë.

Ai nenvizoi se bashkia perbehet nga dy fushë gropa me një reliev te mrekullushëm, e ngritur përreth liqenit të Ohrit dhe krahinës së Mokrës.

Vlerësoi historinë, prejardhjen vlerat e peisazhit dhe mundesine e ruajtjes së zhvillimit të këtyre elementëve të rëndësishëm.

Më pas ai shpjegoi dhe pozicionin topografik të njësisve administrative të Buçimasit ,Udënishtit ,Çërravës,Dardhasit, Proptishtit ,Trebinjës dhe Velçanit.

z.Sazan Guri në emër të specialistëve ekspertëve për mjedisin shpjegoi mbi klimën ,tektonikën,karakteristikat tektonike te zones aktivitetin sizmik në rajonin e Pogradecit, aspektet gjeomjedisore, aktivitetet minerare te shfrytezimit, çështjet ambjentale gjeomonumentet etj.

Më pas ai cilësoi dhe rreziqet e elementëve që ndikojnë në prishjen e sistemeve natyrore.

Për infrastrukturën dhe rrjetet inxhinierike foli ing.Shkëlqim Zeqo.

Ai theksoi më tepër mbi problematikën e rrjetit rrugor ekzistues lidhur me zbatimin e parametrave të kodit rrugor .

Diskutimi vazhdoi me grupe sipas fushave me specialistet dhe ekspertet e grupit te punes dhe drejtorive të bashkisë.

Problematikat dhe mangesite u evidentuan dhe u relatuan.

Për përdorimin e tokës ,analizën e tipologjisë së zhvillimit urban tëterritorit ,analizën e tipologjisë hapësinore ekzistuese, prezantimin e bëri planifikues urban z.Devis.

Diskutimi me i hollësishëm për këtë analizë u krye me specialistët e fushës dhe specialistët e drejtorisë së planifikimit të territorit.

Nga dokumentacioni i paraqitur për këtë analizë pati debat ,mbasi në të kishte mungese te theksuar të pasqyrimit të zhvillimit urban jo vetëmpër njësitë administrative për edhe për qytetin.

Dokumentacioni paraqitej me mangësi dhe pasaktësi të të dhënave dhe për territore dhe problematika që nuk i përkisnin bashkisë Pogradec.

Hartat që shoqërojnë dokumentacionin ishin të pa plotësuara dhe analizuara për çfarë pasqyronin.

Edhe me specialistët e drejtorive te tjera ,ekspertet gjate diskutimit kishin të njëjtin mendim se dokumentacioni paraqitej me mangësi dhe pasaktësi të të dhënave dhe për territore dhe problematika që nuk i përkisnin bashkisë Pogradec.

Problematikat e dala gjate diskutimit dhe vërejtjet e grupit të punes u pasqyruan ne raportin e vleresimit te bashkise per kete faze.

Në vazhdimësi të punës, për raportin e analizës dhe vlerësimit të gjëndjes ekzistuese, për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, mbështetur në ligjin Nr 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", Kontratës me nr 514 prot, datë 27.01.2016 "Hartimi i planeve të përgjithshëm vendor për Bashkinë Pogradec "Akt-Marrëveshjes së bashkëpunimit" Raportin e Vlerësimit Teknik Për Analizën dhe Vlerësimin e Territorit, si dhe proces-verbalin e datës 20.04.2016, për marrjen në dorëzim të produktit, për tenderin "Shërbim Konsulente" me objekt "Hartimi i planeve të Përgjithshme vendore për 26 Bashkitë të Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit", hartuar nga grupi i punës "Për

monitorimin, mbikqyrjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nr.818.prot, datë 20.04.2016, Raportin e Vlerësimit Teknik Për Analizën dhe Vlerësimin e e Territorit”, hartuar nga Bashkia Pogradec rezultoi se:

1-Për sa më sipër dhe takimeve të kryera në datën 21.04.2016 me ekspertët e drejtorive të Bashkisë si dhe diskutimit trepalësh (AKPT, Bashkia Pogradec dhe Studio Konsulente) në datën 25.04.2016, Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka vlerësuar dhe mundësuar të dërgojë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin që disponon përpërmirësimin e ndryshimeve saktësimin e raportit të analizës dhe vlerësimit të gjëndjes ekzistuese, (sidomos në analizën e të gjitha planeve ekzistuese, strategjive, politikave, skanimit të territorit dhe vlerësimit të tij) për hartimin e Planit të Përgjithshëm sipas termave të referencës.

2-Duke vlerësuar raportin e Vlerësimit Teknik të dokumentit “Analiza dhe Vlerësimi i Territorit, të Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, nga grupi i punës dërguar në Bashkinë Pogradec, me nr.1102 prot, datë 22.04.2016 dhe raportin e Vlerësimit Teknik të dokumentit “Analiza dhe Vlerësimi i Territorit” të Bashkisë Pogradec, dërguar në AKPT datën 22.04.2016, në përputhje me termat e Referencës së kontratës me kusht, që në raportin e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit, të reflektohen të gjitha komentet dhe rekomandimet e konkretisht :

- Analiza për çështjet dhe objektet e rëndësisë kombëtare për Bashkinë Pogradec.
- Specifikimi i elementëve përjashtues i zonave të tyre buferike dhe paraqitja e tyre në një hartë të veçantë.
- Pasqyrimi i pozicionit startegjik, vlerësimi identitetit historik, urban dhe ekonomik në raport me rajonin në hartat specifike.
- Pasqyrimi i analizës klimaterike, bonitetit të tokave në hartat specifike
- Plotësimi i analizës për degradimin urban e natyror të terrenit.
- Plotësimi i analizës së tipologjisë të hapësirave për gjithë njësinë vendore.
- Saktësimi dhe paraqitja në hartë e gjithë kategorive bazë sipas specifikimeve të nenit 77 të VKM 671, datë 29.07.2015.
- Mungon analiza SWOT e territorit.
- Saktësimi e analiza e rrjeteve të infrastrukturës (rrjetit elektrik, kanalizimeve, ujit të pijshëm, rrjetit rrugor sipas kategorive të përcaktuara në kodin rrugor, rrjetit telefonik, kabllor etj).
- Analiza e mënyrës së përdorimit të pronave publike, plotësimi i hartës me detajet e përdorimit të tokës, konflikteve dhe situatave të informalitetit.
- Plotësimi i të gjitha shtresave, projeksioneve përkatëse dhe për njësite administrative të bashkisë. Konturimi i shtresave të jetë vetëm për bashkinë, e jo për teritore më të gjëra.
- Të realizohet konvertimi i databazës së përgatitur në formatin e përcaktuar nga AKPT-ja.
- Të realizohet struktura e bazës së të dhënave për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Në kuadër të bashkëpunimit Bashkia Pogradec, ka qene e gatshme dhe ka dërguar dokumentacion dhe informacione (shih bashkangjitur) për realizimin e hartimit të një Plani të Përgjithshëm Vendor, sa më real, cilësor dhe funksional.


Eduart KAPRI
KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradece@gmail.com

Pogradec më 06/06/ 2016

Raport

Mbi ecurinë e punës për Hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Pogradec, faza e dytë (Draft Strategjia Territoriale)

Në datën 26.05.2016, me grupin e punës , ekspertë të fushës, shoqërisë civile, kryetarëve të njësive administrative, drejtorët e drejtorive dhe specialistë të Bashkisë, si dhe studion konsulente Konsorciumi, BOLLES+ WILSONGMB&CD IDRA sh.p.k, u krye dëgjesa për diskutimin e dokumentacionit të platformës strategjike e territorit, për Hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Pogradec, paraqitur nga studio konsulente .

Fjalën e hapjes e mban z.Eduart Kapri, Kryetar i Bashkisë dhe autoriteti përgjegjës për Hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, ku midis të tjerash, duke bërë të njohur rëndësinë e procesit, i kërkoi auditorit për të qënë bashkëpunues, pjesëmarrës dhe vlerësues mbi dokumentacionin e platformës strategjike e territorit, të paraqitur nga studio konsulente, mbështetur në kontratën e lidhur midis Ministrisë së Zhvillimit Urban, Bashkisë Pogradec dhe studio BOLLES+ WILSONGMB & CD IDRA sh.p.k.

Ai i kërkoi auditorit dhënien e kontributit, mendimeve, sugjerimeve për platformën strategjike në territorin administrativ të njësive vendore sot, ecurinë e zhvillimit të territorit në përgjithësi, duke theksuar jo vetëm administrimin e territorit dhe njohjen e problematikave të planifikimit të territorit, platformës strategjike të territorit në qytet por dhe profilat e njësive administrative (së bashku me fshatrat) pjesë përbërëse të bashkisë, e konkretisht të Buçimasit, Udënishtit, Çëravës, Dardhasit, Proptishtit, Trebinjës dhe Velçanit.

Duke qënë në breg të liqenit dhe pjesë e zonës së mbrojtur, vazhdimësi e zhvillimit urban të qytetit, për Buçimasin dhe Udënishtin duhet të evidentohen dhe saktësohen të gjitha prioritetet, strategjitë në dokumentacionin e hartimit të planit .

Mendoj se gjithë stafi i bashkisë, grupi i punës, ekspertët, drejtorët e drejtorive dhe specialistët e Bashkisë, kanë punuar në mbështetje të studios konsulente për informimin, diskutimin dhe vënien në dispozicion të gjithë dokumentacionit që disponon bashkia lidhur me planet strategjike ekzistuese të territorit të bashkisë.

Përpara se të prezantohej platforma strategjike e territorit, nga auditori u pyet se kush e kish fituar tenderin për hartimin e PPV-së së Bashkisë Pogradec, mbasi në çdo takim ka patur gjithmonë vetëm ekspertë të "IDRA "sh.p.k dhe asnjë përfaqësues nga BOLLES+ WILSONGMB.

Më pas prezanton dokumentin z.Denis Agaraj. përfaqësues i studio BOLLES+WILSONGMB&CD IDRA sh.p.k, i cili në emër të grupit të specialistëve spjeron punën e kryer deri tani "Për hartimin e platformës strategjike të territorit", për të gjithë bashkinë . Dokumentacioni i përgatitur është faza e dytë e procesit i cili përmban:

I-gjëndjen ekzistuese dhe problematikat e territorit

- 1-Vështrim i përgjithshëm, profilat e njësive administrative, zhvillimi i territorit të bashkisë në vite
- 2-Dokumentet e planifikimit, konventat ndërkombëtare, marrëveshjet bilaterale, strategjitë dhe programet në nivel ndërkombëtar, analiza e planeve dhe instrumentave në nivel kombëtar, vendor, plani Rregullues i Bashkisë Pogradec.
- 3-Veçoritë fizike dhe mjedisore, topografia dhe relievi, klima
- 4-Mjedisi dhe ekosistemet, habitati dhe biodiversiteti, territori, toka dhe nëntoka, burimet ujore, pasuritë minerale, ajri, mbetjet.
- 5-Përdorimi i tokës dhe infrastruktura, sistemet në territorin e bashkisë Pogradec, përdorimi i tokës, infrastruktura rrugore, rrjetet inxhinierike të infrastrukturës, të dhëna mbi infrastrukturën e rrjetit elektrik, rrjetin e ujës-jellsit, rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza.
- 6-Zhvillimi social dhe ekonomik, demografia, zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, personat me aftësi të kufizuara, zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social, aspektet ekonomike, identiteti ekonomik, bujqësia, sektori i industrisë, turizmi.
- 7-Zonat e Rëndësisë Kombëtare në territorin e Bashkisë Pogradec, përshkrimi i zonës, Monumentet Arkeologjike, tipet e gjeomonumenteve, monumentet kulturore, historike dhe natyrore të peisazhit të mbrojtur.
- 8-Situata financiare e bashkisë, shpenzimet dhe investimet, detyrime të papaguara
- 9-Konkluzione, rekomandime dhe SËOT

II-Vizioni dhe strategjia territoriale

- 1-Formulimi i vizionit dhe strategjisë për zhvillimin territorial të njësisë vendore.
- 2-Vizioni i zhvillimit të territorit të bashkisë, objektivat strategjike dhe programet strategjike për zhvillimin e territorit, drejtimet për zhvillimin e territorit të bashkisë.
- 3-Plani i veprimeve prioritare, investimet startegjike dhe projektet pilot të zhvillimit ,programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, termat kohorë, aktorët, monitorimi dhe buxheti, evidentimi i projekteve pilot të zhvillimit.
- 4-Përfshirja e palëve të interesuar dhe takimi publik, identifikimi i palëve të interesuara, konsultimi me palët dhe dëgjesa publike

III-Aneks

- 1-Platforma GIS, shënime dhe referenca.

Platforma strategjike e territorit, për Hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Pogradec, u spjegua nëpërmjet figurave dhe tabelave që bashkangjiteshin dokumentit.

Mbas prezantimit të dokumentacionit të mësipërm vlerësimi të punës të kryer nga studio konsulente, BOLLES+ WILSONGMB&CD IDRA sh.p.k, po relatojmë, problematikat dhe mangesite që u evidentuan nga auditori si mëposhtë:

-Dokumentacioni nuk ka marrë në konsideratë, konventat ndërkombëtare, planet kombëtare për ruajtjen e peisazhit, mjedisit, planet urbanistike të miratuara ndër vite, master-planin e bregut të liqenit për zonën turistike Lin-Pogradec, Pogradec-Tushemisht etj të miratuara nga K.RR.T.SH-jaetj

-Plani strategjik i hartuar nga bashkia së bashku me USAID-in, bërë nga ekspertë e specialistë profesionistë që e kanë dashur dhe e duan këtë qytet, nuk paqyrohet në dokumentacionin e platformës strategjike të territorit.

-Në përdorimi i tokës(nuk ka analizë të territorit), sistemeve dhe infrastrukturave, (ka vetëm harta).Rekomandohet rizhvillimi i sistemit hekurudhor, kur një nga objektivat dhe strategjitë e zhvillimit të territorit e vizioni për bashkinë e Pogradecit dhe sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar, është zhvillimi, si rajon ndërkufitar, si pjesë e një rajoni ekonomik të rëndësishëm atë Elbasan-Pogradec-Korçë, i një rajoni të turizmit liqenor.....etj

-Zona e urbanizuar e miratuar nga KKT-ja dhe pasqyruar në hartat e dokumentacionit të platformës strategjike e territorit, lë zona dhe fshatra(Çervenaka) jashtë kufirit të zonës së urbanizuar .

-Kufiri dhe sipërfaqja e territorit të njësisë administrative vendore për bashkinë e Pogradecit ka pasaktësi .

- Për zhvillimin e mëtejshëm të strukturës dhe shërbimit, shëndetsor e arësimor për bashkinë e Pogradecit, nuk janë pasqyruar tregues dhe rekomandime si mendohet për zhvillimin e mëtejshëm.

- Në platformën strategjike te territorit, nuk janë parashikuar zgjidhjet e problemeve të infrastrukturës rrugore,(shkarje,erozioni) rrjetet inxhinierike të infrastrukturës(për infrastrukturën e rrjetit elektrik, rrjetin e ujësjellsit, rrjetin e kanalizimeve të ujrave të shiut (përmbytjet nga mungesa e kanalit të ujrave te larta), rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza, për zonën e bregut të liqenit Pogradec-Lin e jo vetëm etj.....

-Në zhvillimin ekonomik, profilat e njësive administrative mungon profili i qytetit, identiteti ekonomik i zhvillimit ,vizioni i njësive administrative dhe qytetit.

-Vizioni i zhvillimit të territorit të bashkisë, objektivat strategjike kanë nevojë për një analizë më specifike dhe saktësim të programeve strategjike për zhvillimin e territorit sipas projekteve pilot të zhvillimit .

-Nga takimi e dëgjesa publike u identifikua se ka pasaktësi dhe mos marrje në konsideratë të mendimeve dhe vërejtjeve nga palët e interesuara në dokumentacionin e paraqitur. nga studio konsulente si dhe se ka ndërhyrje të politikës në zhvillimin urban të bashkisë Pogradec.

Në vazhdimësi të punës, për përfundimin e dokumentacionit për strategjine e territorit, për Hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Pogradec, mbështetur në ligjin Nr 107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", Kontratës me nr 514 prot, datë 27.01.2016, "Hartimi i planeve të përgjithshme vendore, për Bashkinë Pogradec, "Akt-Marrëveshjes së bashkëpunimit, rezultoi se :

1-Për sa më sipër dhe dëgjësës publike të datës 26.05.2016 me grupet e interesit, forumin këshëllimor, ekspertët e drejtorive të Bashkisë, drejtoria e planifikimit të territorit ka bashkëpunuar me grupin e caktuar nga studio konsulente, për saktësimin e të gjithë informacionit dhe dokumentacionit qe disponon për përmirësimin e dokumentacionit për strategjine e territorit, (sidomos në analizën e të gjitha planeve ekzistuese, strategjive, politikave, skanimit të territorit dhe vlerësimit të tij) për hartimin e Planit të Përgjithshëm sipas termave te references.

2-Në raportin e Vlerësimit Teknik të dokumentit, "Analiza dhe Vlerësimi i Territorit", dërguar nga Agjensia Kombëtare të Planifikimit të Territorit, në Bashkinë Pogradec, me nr 1102 prot, datë 22.04.2016 dhe raportin e Vlerësimit Teknik të dokumentit, "Analiza dhe Vlerësimi i Territorit" të Bashkisë Pogradec, dërguar në AKPT datën 22.04.2016, në përputhje me termat e Referencës së kontratës është lënë detyrë për të dorëzuar dokumentin e " Analizës së thelluar të gjëndjes ekzistuese të territorit", detyrë e cila nuk është realizuar.

Në kuadër të bashkëpunimit Bashkia, është e gatëshme, për të dhënë kontributin e saj në realizimin sa më real e cilësor të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor.


Eduart KAPRI
KRYETAR